



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 93

6 gusht

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Akt normativ i KM nr.3, datë 1.8.2012	Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar.....	5111
Vendim i KM nr. 428, datë 20.6.2012	Për shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Sarandës dhe miratimin e rregullores së administrimit.....	5113
Vendim i KM nr. 429, datë 4.7.2012	Për një shtesë në vendimin nr. 742, datë 8.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Drenovë të qarkut të Korçës”.....	5118
Vendim i KM nr. 430, datë 4.7.2012	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Shosh të qarkut të Shkodrës.....	5119
Vendim i KM nr. 431, datë 4.7.2012	Për një shtesë në vendimin nr. 948, datë 2.9.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Gradishtë, të qarkut të Fierit”.....	5119
Udhëzim i MASH nr. 8, datë 28.6.2012	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 24, datë 30.7.2010 “Për përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkencëtarët e rinj, të shkëlqyer.....	5120
Udhëzim i MASH nr. 9, datë 4.7.2012	Për një shtesë në udhëzimin nr. 1, datë 19.1.2012 “Për procedurat e njehsimit të dëftesave/diplomave të shkollave të mesme të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit”.....	5122
Udhëzim i MPPT nr. 8, datë 29.6.2012	Për kriteret bazë për njohjen e licencave të huaja të personelit të mirëmbajtjes së avionit, në licencë të mirëmbajtësit aeronautik.....	5122
Urdhër i MB nr. 230, datë 5.7.2012	Për delegim kompetencash.....	5125
Vendim i ERE nr. 82, datë 29.6.2012	Për miratimin e një ndryshimi në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike.....	5125

Vendim i ERE nr. 83, datë 29.6.2012	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et “Cemerica 1”, “Cemerica 2”, “Cemerica 3”	5126
Vendim i ERE nr. 84, datë 29.6.2012	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	5127
Vendim i ERE nr. 85, datë 29.6.2012	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Seament Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	5127
Vendim i ERE nr. 86, datë 29.6.2012	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Seament Albania” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike	5128
Vendim i ERE nr. 87, datë 29.6.2012	Për rishikimin e tarifës së furnizuesit publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, për akomodimin e efekteve financiare të vendimit nr. 80, datë 15.6.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.....	5129
Vendim i ERE nr. 88, datë 29.6.2012	Për miratimin e pagesave të rregullimit për vitin 2012.....	5130
Vendim i ERE nr. 89, datë 29.6.2012	Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve në masën 100% nga kompania “Hec Lanabregas” te subjekti “Ujësjetës-Kanalizime” sh.a. Tiranë.....	5132
Vendim i ERE nr. 90, datë 29.6.2012	Për fillimin e procedurave mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hec Vlushe” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të saj si kolateral pranë Bankës Kombëtare Tregtare.....	5133
Vendim i ERE nr. 91, datë 29.6.2012	Për licencimin e shoqërisë “GJO SPA Power” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Lapaj”	5133
Vendim i KKRT nr. 87, datë 22.6.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “TV kabllor Tepelena Sat”.....	5134
Vendim i KKRT nr. 88, datë 22.6.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Lushnja”.....	5135
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Shkëlqim Sadedinaj.....	5135
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasës Irena Seli.....	5135
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasës Verore Hoxha.....	5135

AKT NORMATIV
Nr. 3, datë 1.8.2012

**PËR LIRIMIN E BANESAVE PRONARËVE TË LIGJSHËM NGA QYTETARËT E
PASTREHË, BANUES NË BANESAT ISH-PRONË E SUBJEKTEVE TË SHPRONËSUARA**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Lirimin dhe dorëzimin e banesës nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar, emrat e të cilëve janë dërguar nga Enti Kombëtar i Banesave në Bankën Kombëtare Tregtare, në vijim referuar BKT, për kreditim, në kushtet deri 30 vjet afat, me 0 (zero) % interes vjetor, sipas programit social të trajtimit me kredi të lehtësuar nga shteti, në zbatim të udhëzimit nr. 6257, datë 2.9.2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, të ndryshuar, apo që duhet të aplikohet për këtë projekt strehimi, brenda datës 1 nëntor 2012.

Neni 2

Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave të dorëzojë në BKT, deri më 5 shtator 2012, listën e qytetarëve të pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar, që kanë aplikuar apo nuk kanë aplikuar ende në Entin Kombëtar të Banesave, me gjithë njoftimin publik të bërë më 4.11.2009. Lista publikohet e plotë edhe në faqen zyrtare të Entit Kombëtar të Banesave, brenda datës 5 shtator 2012.

Neni 3

Kur lirimi dhe dorëzimi i banesës sipas nenit 1, të këtij akti normativ, nuk ndodh brenda datës 1 nëntor 2012, pronari i pronës ose një përfaqësues ligjor i ngarkuar prej tij, me autorizim të posaçëm, i dërgon Entit Kombëtar të Banesave njoftimin respektiv.

Enti Kombëtar i Banesave, brenda 2 (dy) ditëve pune nga marrja e njoftimit me shkrim, konfirmon, me shkrim, se qytetari/ët i/e pastrehë është/janë në listën e botuar për trajtim me kredi me 0 (zero) % interes në vit, për një afat kohor deri në 30 vjet.

Ky konfirmim, në kuptim të këtij akti normativ, përbën titull ekzekutiv sipas nenit 510, shkronja “e”, të Kodit të Procedurës Civile dhe Entit Kombëtar i Banesave, brenda 1 (një) dite pune, regjistron kërkesën për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, në gjykatën ku ndodhet pasuria e paluajtshme, në favor të kreditorit.

E gjithë procedura e lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, në gjykatë, në emër të kreditorit, kryhet nga punonjës të Entit Kombëtar të Banesave dhe informacioni publikohet në faqen zyrtare të këtij enti.

Enti Kombëtar i Banesave i dorëzon me procesverbal me shkrim, pronarit të tokës apo përfaqësuesit ligjor të ngarkuar prej tij me autorizim të posaçëm, urdhrin e ekzekutimit.

Pronari i pronës ose një përfaqësues i ngarkuar prej tij me autorizim të posaçëm ka të drejtë t'i drejtohet shërbimit përmbartimor gjyqësor, pas lëshimit të urdhrin të ekzekutimit nga gjykata, që të bëjë lirimin e banesës. Gjykatat e Shkallës së Parë nuk mund të kryejë pezullimin e këtij urdhri ekzekutimi.



Neni 4

Për çdo qytetar të pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara, që nuk liron banesat, ndonëse janë në listat e dërguara nga Enti Kombëtar i Banesave në bankën e BKT-së për kreditim, në kushtet deri 30 vjet me 0 (zero) % interes vjetor, pas ekzekutimit të titullit ekzekutiv, sipas nenit 4, veprohet si më poshtë vijon:

- Trajtohen me strehim në banesa sociale nga këshillat bashkiakë, duke pasur përparësi në programet e banesave sociale për qira. Këshillat bashkiakë të bashkive përkatëse, brenda datës 15 nëntor 2012, ftohen të planifikojnë numrin e banesave, kur objektet janë me fonde të tyre. Për financime me fondet e pushtetit qendror, këshillat bashkiakë duhet të shpërndajnë të paktën 1/2, e kuotës për këtë kontigjent.

- Për persona të moshuar, të paaftë të kujdesen dhe pa persona të tjerë në ngarkim, kur nuk dëshirojnë me deklarament me shkrim, sistemim me qira apo, sipas verifikimit të kryer, janë të paaftë të kujdesen për vete, bëhet sistemimi me strehimin e tyre në qendrat e përkujdesjes për moshat e treta.

Neni 5

Fondet e parashikuara për kredi për të pastrehët në familje me ish-pronarë, u rialokohen buxheteve vendore, njësitë e të cilave kanë sistemuar qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara brenda tremujorit të parë të vitit 2013, për programin strehim.

Neni 6

Ftohen ish-pronarët apo përfaqësuesit ligjorë të tyre, që kanë të dhëna se qytetarët e pastrehë që mbajnë pronat e tyre disponojnë pasuri të luajtshme ose të paluajtshme në të njëjtin rreth apo kanë të dhëna se nuk banojnë më në mjediset e tyre apo i mbajnë të mbyllura, t'ia vënë në dispozicion Entit Kombëtar të Banesave, me qëllim verifikimin e të dhënave që disponojnë ata nga deklaramentet. Enti Kombëtar i Banesave nis menjëherë verifikimin, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse. Brenda 20 (njëzet) ditëve pune Enti Kombëtar i Banesave përfundon verifikimin. Të gjitha autoritetet publike dhe shtetërore detyrohen t'i kthejnë përgjigje një kërkesë të Entit për verifikim, në kuptim të këtij neni, brenda 2 (dy) ditëve pune. Në përfundim të verifikimit Enti Kombëtar i Banesave vendos:

- të përfundojë shqyrtimin pasi të dhënat janë të paplota ose të rreme;
- të bëjë kallëzim penal pasi subjekti i pastrehë ka deklaruar të dhëna të rreme, përdor në mënyrë të paligjshme këtë pronë pasi është pronar, disponon pasuri të luajtshme apo të paluajtshme në të njëjtin rreth apo ka të dhëna zyrtare se nuk banon në pronën e ish-pronarëve;
- të pushojë shqyrtimin pasi ka ndodhur lirimi dhe dorëzimi i pronës pronarit të ligjshëm;

Me kërkesë me shkrim të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave ka të drejtë të nisë verifikimin për shkaqe, sipas paragrafit 1 të këtij neni për 10-30% të listës së ish-pronarëve, sipas listës për çdo qark.

Verifikimi kryhet brenda 2 (dy) muajve dhe publikohet si raport në faqen zyrtare të Ministrisë dhe Entit Kombëtar të Banesave, në kuadër të transparencës së këtij procesi. Çdo agjenci shtetërore ka detyrimin të vendosë dokumentacionin në dispozicion të Entit Kombëtar të Banesave brenda 2 (dy) ditëve pune nga marrja e kërkesës.

Neni 7

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 428, datë 20.6.2012

**PËR SHPALLJEN E ZONAVE ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË QYTETIT TË SARANDËS
DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2 të nenit 30 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Sarandës, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike, të përcaktuara në aneksin 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Në pikën 1 të vendimit nr. 6, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e zonave arkeologjike, brenda qendrave të banuara në Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë dhe Sarandë”, zonifikimi për qytetin e Sarandës shfuqizohet.
3. Miratimin e rregullores së administrimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Sarandës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe organet e njësisë së qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E ZONËS ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË QYTETIT TË SARANDËS

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për administrimin e zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Sarandës, mbështetur në ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar.

Neni 2
Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Sarandës

Në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Sarandës lejohet:

1. Restaurimi dhe konservimi i monumenteve dhe strukturave arkeologjike, kryerja e sondazheve arkeologjike me synim studimin e plotë të zonës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.
2. Rikonstruksioni i rrugëve dhe të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik ujësjellës-kanalizime, ndriçim, telefoni, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.
3. Vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal) me lartësi maksimale 3 m, të cilat duhen realizuar larg mureve dhe strukturave të tjera të dallueshme apo të supozuara. Konstruksionet vendosen dhe përdoren nga institucionet shtetërore të specializuara, duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe që në asnjë rast nuk dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin, në funksion të ruajtjes,



ekspozimit, informimit publik dhe nevojave të tjera që lidhen me veprimtarinë arkeologjike në veçanti dhe trashëgiminë kulturore në përgjithësi.

4. Projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe për çdo rast duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës, si dhe planprojektin e saj.

Neni 3

Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “B” të qytetit të Sarandës

Në zonën arkeologjike “B” të qytetit të Sarandës lejohen:

1. Ndërtimet e reja pas miratimit me shkrim nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë të kërkesave të subjekteve të interesuara.

2. Ndërtimet lejohen vetëm pas kryerjes paraprake nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik të vëzhgimit intensiv, sondazheve arkeologjike apo formave të tjera të testimit në varësi të potencialit që përfaqëson zona me miratim të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

3. Format e testimit përcaktohen nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, por kryesisht janë sondazhe që nuk cenon shtresat në rast të vijimit të gërmimit arkeologjik, studime gjeofizike, regjistrim digjital i terrenit, vëzhgim intensiv arkeologjik etj.

4. Në rastet kur gjatë zbatimit të projektit ndërtimor zbulohen gjetje të rëndësishme të veçantë, projekti duhet të rishikohet. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë miraton ndryshimet në projekt duke marrë në konsideratë konservimin, ruajtjen, si dhe bërjen e tyre të vizitueshme. Vetëm pas miratimit të ndryshimeve lejohet vazhdimi i punimeve.

Neni 4

Ndërhyrja e zonës arkeologjike “B” të Kalasë së Lëkurësit, Sarandë

Për zonën arkeologjike “B” të Kalasë së Lëkurësit, konkretisht në rrënojat e fshatit mesjetar, lejohen vetëm rindërtimet, që respektojnë vëllimet e rrënojave të vjetra, jo më të larta se 2 kate, me elemente ndërtimore, arkitekturore dhe fasada të shtëpive tradicionale të asaj kohe.

Për çdo rast leja për rindërtimin në këtë zonë do të miratohet nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë.

Neni 5

Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet ndërtimore në zonën arkeologjike “B”, Sarandë

1. Për çdo ndërhyrje në zonat arkeologjike “B”, subjekti ndërtues i interesuar vë në dijeni Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare-Sarandë dhe paraqet pranë Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë dokumentacionin si më poshtë:

- Fotokopje e noterizuar e lejes së sheshit të ndërtimit nga KRRT/KRRTRSH;
- Fotokopje e noterizuar e vendimit të gjykatës ose regjistrimit në QKR;
- Prokurë për personin e autorizuar për nënshkrimin e kontratës nëse nuk është administratori i subjektit.

2. Pas shqyrtimit dhe miratimit të kërkesës së subjektit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik nënshkruan një kontratë me subjektin për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve.

Neni 6

Ndërhyrjet pa leje

1. Për ndërhyrjet pa leje brenda zonës arkeologjike “B”, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare-Sarandë pezullon menjëherë veprimtarinë e subjektin dhe njofton Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe strukturën përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Në rast se subjekti nuk pezullon veprimet brenda 24-orëve Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare-Sarandë i drejtohet menjëherë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor dhe Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar për pezullimin e ndërtimit deri në prishjen e tij.

Neni 7

Në rast të shkeljeve të procedurave nga subjektet ndërtimore, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë për subjektin, si dhe për drejtuesin teknik përkatës, nuk merr në shqyrtim për një periudhë 3-vjeçare asnjë kërkesë për ndërtim në zona arkeologjike “B” në të gjithë territorin e vendit, apo në zona të tjera, ku sipas ligjit kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

Neni 8

Gjetjet arkeologjike

1. Klasifikohen si vlera të rëndësishme objektet e luajtshme dhe të paluajtshme në kontekstet arkeologjike, struktura murale (varre monumentale, pjesë mozaiku të shtrirë në një sipërfaqe mbi 4 m², afreske, ndërtime inxhinierike, pjesë arkitekturore që lidhen me strukturat murale dhe banesa, tempuj e godina të tjera shërbimesh).

2. Në rast gjetjesh të rëndësishme të paluajtshme, punimet e nisura pezullohen menjëherë nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik. Brenda afatit prej 10 ditësh nga ndërprerja e punimeve, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë vendos për veprimet e mëtejshme. Veprimet e mëtejshme në lidhje me vazhdimin e ndërtimit do të ndërmerren nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në cilësinë e Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, jo më vonë se 30 ditë nga ndërprerja e punimeve. Nëse gjetjet janë me vlera të rëndësishme, punimet e filluara të ndërpriten përfundimisht. Vendimi në këtë rast merret nga organi që ka autorizuar fillimin e punimeve, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë.

3. Në rast se Agjencia e Shërbimit Arkeologjik i propozon ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore shpalljen monument kulture të një objekti të paluajtshëm, Instituti i Monumenteve të Kulturës bën studimin e zonës mbrojtëse të saj brenda 30-ditëve nga zbardhja e vendimit për shpalljen monument kulture.

4. Shpenzimet për kryerjen e hulumtimeve të nevojshme, përgatitjen e dokumentacionit, si dhe për ndryshimet e mundshme të projektit kur vendoset që gjetjet të mbrohen në vend (*in situ*), të gjitha shpenzimet për to, si dhe shpenzimet për kërkimet shkencore, veprimtaritë e nevojshme restauruese ose konservuese mbulohen 100% nga investitori.

5. Në rast të gjetjeve arkeologjike të rëndësishme kur Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë vendos ndërprerjen përfundimtare të punimeve, investitori shpronësohet në bazë të kuadrit ligjor në fuqi.

Neni 9

Gërmimet e shpëtimit

1. Në rast gjetjesh arkeologjike, zhvillohet gërmimi i shpëtimit. Gërmimi i shpëtimit kryhet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare-Sarandë, ose nga subjekte private me leje të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, nën mbikëqyrjen e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

2. Në rast se gjatë kryerjes së gërmimit të shpëtimit gjykohet e nevojshme asistencë shkencore dhe teknike në terren e specialistëve të Institutit të Arkeologjisë, kërkohet zyrtarisht pjesëmarrja e tyre në gërmim.

3. Nëse pas kryerjes së gërmimit të shpëtimit zbulohen gjetje të rëndësishme të veçantë (strukturë etj.), Agjencia e Shërbimit Arkeologjik pezullon gërmimin dhe propozon në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë ndryshimet në projekt, me synim mbrojtjen dhe bërjen të vizitueshme të këtyre vlerave.

4. Vazhdimi i punimeve ndërtimore lejohet pas verifikimit nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik të përmbushjes së kriterëve të vendosura nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë për zbatimin korrekt të projektit të mbrojtjes dhe vizitueshmërisë.

5. Në përfundim të çdo gërmimi shpëtimi përgatitet një relacjon i plotë i cili i paraqitet Këshillit



Kombëtar të Arkeologjisë për miratim brenda 30 ditëve. Pas shqyrtimit dhe miratimit, një kopje e relacionit të plotë depozitohet edhe pranë Institutit të Arkeologjisë.

6. Në rastin kur gërmimi i shpëtimit kryhet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, relacioni firmoset nga drejtuesi i grupit dhe nga anëtarët e tij, si dhe konfirmohet nga drejtori i Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

7. Në rastin kur gërmimi i shpëtimit kryhet nga një subjekt privat, relacioni firmoset/konfirmohet nga drejtuesi i projektit të subjektit, minimumi 2 arkeologë të këtij subjekti dhe nga specialisti i autorizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, i cili ka qenë prezent gjatë gërmimit.

Neni 10

1. Vëzhgimi intensiv sipërfaqësor (*survey*) dhe sondazhet arkeologjike kryhen nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare-Sarandë. Në çdo projekt të ndërmarrë nga subjektet, është e detyrueshme pjesëmarrja e një përfaqësuesi të autorizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

2. Kur subjekti privat kryen shkelje duke mos respektuar legjislacionin në fuqi, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik pezullon gërmimin dhe relaton menjëherë në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë, duke propozuar edhe masat përkatëse. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik vulos kantierin dhe e monitoron atë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës, Kombëtare-Sarandë.

3. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë pasi shqyrton rastin vendos:

- a) Lënien në fuqi të vendimit të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik për pezullimin e punimeve;
- b) Shfuqizimin e vendimit për pezullim dhe lejimin e vijimit të punimeve.

4. Në rastet kur subjekti privat nuk e kryen gërmimin sipas kuadrit ligjor në fuqi, KKA-ja i delegon ASHA-së të vazhdojë gërmimet.

5. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë është i formës së prerë.

Neni 11

Vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese

1. Në zonën arkeologjike “A” dhe “B” vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik bëhet vetëm në vendet e përcaktuara sipas rasti nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Agjencia e Shërbimeve Arkeologjike dhe zbatohet nga Drejtoria Rajonale e Kulturës, Kombëtare-Sarandë.

2. Në asnjë rast tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo konkurrojnë monumentin.

3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë monumenteve dhe zonave të mbrojtura rreth tyre bëhet në mbikëqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare-Sarandë.

4. Për çdo veprimtari me karakter kulturor në zonat arkeologjike “A” dhe “B”, vendosja e tabelave dhe e materialeve publicitare lejohet në raste të veçanta festivo-kulturore dhe ka karakter të përkohshëm. Vendosja e tyre ekzekutohet vetëm në zbatim të urdhrit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe nën mbikëqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare-Sarandë.

5. Është e ndaluar vendosja e posterave publicitarë (jokulturorë) dhe politikë, si dhe dëmtimet e tjera të monumenteve dhe rrënojave arkeologjike (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme).

Neni 12

Kjo rregullore shoqërohet me hartën e zonifikimit, e cila rishikohet periodikisht nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës, bazuar në të dhënat e reja arkeologjike, si dhe nevojën për mbrojtjen e monumenteve.

Neni 13

Në studimet urbanistike për qytetin e Sarandës duhet të merret parasysh zonifikimi arkeologjik i qytetit të Sarandës dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje.

Studimet urbanistike të miratuara që janë në fazën e implementimit, si dhe rregulloret përkatëse të tyre duhet të rishikohen me qëllim që të zbatohet zonifikimi arkeologjik i qytetit të Sarandës dhe përcaktimet e rregullores përkatëse.

Neni 14

Kësaj rregulloreje i bashkëlidhet:

Harta e zonifikimit arkeologjik të qytetit të Sarandës me koordinatat përkatëse gjeografike të marra GPS (Garmin 60CSx).

Tabela me koordinatat gjeografike të marra me GPS (Garmin 60CSx).

ANEKSI I

PIKAT E MARRA ME GPS “GARMIN 60” TË ZONAVE ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË QYTETIT TË SARANDËS

Nr.	Pozicioni Gjeografik Zona “A”
A	34 S 414820 4414159
A1	34 S 414843 4414361
A2	34 S 414835 4414507
A3	34 S 414987 4414561
A4	34 S 415036 4414429
A5	34 S 415054 4414380
A6	34 S 415290 4414345
A7	34 S 415275 4414274
A8	34 S 415159 4414221
A9	34 S 414895 4414118

Perimetri: 1.7 km

Sipërfaqja: 0.1 km²

Nr.	Pozicioni Gjeografik Zona “B”
B	34 S 416788 4413342
B1	34 S 416798 4413312
B2	34 S 416795 4413274
B3	34 S 416737 4413261
B4	34 S 416635 4413283
B5	34 S 416599 4413341
B6	34 S 416670 4413390
B7	34 S 416725 4413379
B8	34 S 417016 4412878
B9	34 S 417045 4412704
B10	34 S 416978 4412516
B11	34 S 416882 4412580

Perimetri: 3 km

Sipërfaqja: 0.2 km²



VENDIM
Nr. 429, datë 4.7.2012

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 742, DATË 8.9.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË
PËRDORIM TË KOMUNËS DRENOVË TË QARKUT TË KORÇËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 742, datë 8.9.2010 të Këshillit të Ministrave, të shtohen pronat me nr. 574 - 575 (pesëqind e shtatëdhjetë e katër - pesëqind e shtatëdhjetë e pesë), gjithsej 2 (dy) prona, sipas lidhjes nr. 1 dhe formularit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Drenovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Drenovë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit	Lloji i transferimit
574	Prona që përdoren për realizimin e programeve social-kulturore e sportive	Në pronësi
575	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi

FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta shtetërore) shtesë

Nr.	Z.K	Nr.i pas.	Lloji i pronës	Fshati	Sip.m²	7	8	9	10
574	3088	282/7	Vatër kulture	Qatrom	450		Komuna Drenovë		
575	1446		Shkollë	Dardhë	420		Komuna Drenovë		

VENDIM
Nr. 430, datë 4.7.2012

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË KOMUNËN SHOSH TË QARKUT TË SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të komunës Shosh të qarkut të Shkodrës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 84 (tetëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 596 (pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë).

2. Ndryshimet, që mund t’i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 431, datë 4.7.2012

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 948, DATË 2.9.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS GRADISHTË, TË QARKUT TË FIERIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 948, datë 2.9.2009 të Këshillit të Ministrave, shtohen pronat me nr. 291-294, sipas lidhjes nr. 1 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Gradishtë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Komuna Gradishtë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit	Lloji i transferimit
185, 186	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
291	Tokë bujqësore pa fruta	Në pronësi
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
13-16	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
17-21	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive	Në pronësi
22-38	Shërbim funeral	Në pronësi
293	Prona që përdoren në ushtrimin e funksioneve administrative	Në pronësi
294	Prona që përdoren në furnizimin me ujë të pijshëm	Në pronësi

UDHËZIM

Nr. 8, datë 28.6.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 30.7.2010 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, MASËS DHE PROCEDURAVE PËR PËRFITUESIT NGA FONDI I EKSELENCËS PËR STUDENTËT E SHKENCËTARËT E RINJ, TË SHKËLQYER

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012” dhe të vendimit nr. 554, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për fondin e ekselencës, për mbështetje financiare të studentëve e shkencëtarëve të rinj, të shkëlqyer”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në kreun II të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010 “Për përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkencëtarët e rinj, të shkëlqyer”, bëhen këto ndryshime:

1. Germa “b” e pikës 1, të ndryshohet si më poshtë:

“b) Kanë arritur notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës dhe mbi 9.5, për shkencat ekonomike e shoqërore ose, përkatësisht, mbi 8 (B, sipas sistemit anglosakson) për shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës, dhe mbi 8.5 (B+, sipas sistemit anglosakson), për shkencat ekonomike e shoqërore, për studimet e kryera jashtë shtetit në secilin cikël studimi.”.

2. Germa “a” e pikës 3.1, të ndryshohet si më poshtë:

“a) STP-ja verifikon plotësimin e dosjes me dokumentet e kërkuara në shtojcën nr. 1 të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010. Kandidatët që paraqesin mangësi në dokumentacionin e aplikimit, përjashtohen nga përzgjedhja në fazat e mëtejshme.”.

3. Germa “a” e pikës 3.2, të ndryshohet si më poshtë:

“a) KP-të bëjnë një vlerësim për plotësimin e kriterëve dhe klasifikimin e kandidatëve përmes një sistemi pikëzimi, për fazën e intervistës.”.

4. Gerrat “a” dhe “b” të pikës 3.4, të ndryshohen si më poshtë:

“a) KP-të në bashkëpunim me STP-në, mbi bazën e rezultateve të përzgjedhjes së parë, si dhe të atyre të intervistës, bëjnë klasifikimin përfundimtar të kandidatëve, të nënshkruar nga anëtarët e KP-ve.

b) Kjo listë i dërgohet Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës për miratimin e kandidatëve fitues.”.

II. Në kreun III të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010 “Për përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkencëtarët e rinj, të shkëlqyer”, bëhen këto ndryshime:

1. Germa “a” e pikës 4.1 të ndryshohet si më poshtë:

“a) STP-ja verifikon plotësimin e dosjes me dokumentet e kërkuara në shtojcën nr. 2 të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010. Kandidatët që paraqesin mangësi në dokumentacionin e aplikimit, përjashtohen nga përzgjedhja në fazat e mëtejshme.”.

2. Germa “a” e pikës 4.2, të ndryshohet si më poshtë:

“a) KP-të, bëjnë një vlerësim dhe klasifikim të kandidatëve përmes një sistemi pikëzimi për fazën e intervistës.”

3. Gerrat “a” dhe “b” të pikës 4.4, të ndryshohen si më poshtë:

“a) KP-të në bashkëpunim me STP, mbi bazën e rezultateve të përzgjedhjes së parë, si dhe të atyre të intervistës bëjnë klasifikimin përfundimtar të kandidatëve, të nënshkruar nga anëtarët e KP-së.

b) kjo listë i dërgohet Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës për miratimin e kandidatëve fitues.”.

III. Në kreun IV të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010 “Për përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për përfituesin nga fondi i ekselencës për studentët e shkencëtarët e rinj të shkëlqyer”, bëhen këto ndryshime:

1. Germa “a” e pikës 2.1, të ndryshohet si më poshtë:

“a) STP-ja verifikon plotësimin e dosjes me dokumentet e kërkuara në shtojcën nr. 3 të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010. Kandidatët që paraqesin mangësi në dokumentacionin e aplikimit, përjashtohen nga përzgjedhja në fazat e mëtejshme.”.

2. Gerrat “a” dhe “b” të pikës 2.2, të ndryshohen si më poshtë:

“a) KP-të, mbi bazën e rezultateve të përzgjedhjes së parë, si dhe të atyre të intervistës bëjnë klasifikimin përfundimtar të kandidatëve.

b) Kjo listë i dërgohet Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës për miratimin e kandidatëve fitues.”.

IV. Në kreun VI të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010 “Për përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkencëtarët e rinj, të shkëlqyer”, bëhen këto ndryshime.

1. Pika 1.1, të ndryshohet si më poshtë:

“1.1 Studentët që aplikojnë për ciklin e parë të studimeve, të kenë përfunduar arsimin parauniversitar me mesatare mbi 9 të të gjitha viteve të shkollës së mesme ose ekuivalente për ata që kanë përfunduar arsimin parauniversitar jashtë vendit me vlerësimin (A- deri A, sipas sistemit anglosakson).”.

2. Pika 1.2 të ndryshohet si më poshtë:

“1.2 Studentët që aplikojnë për ciklin e dytë të studimeve, të kenë përfunduar studimet e ciklit të parë, me notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës dhe mbi 9.5, për shkencat ekonomike e shoqërore ose përkatësisht, mbi 8 (B) për shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës dhe mbi 8.5 (B+), për shkencat ekonomike e shoqërore, për studimet e kryera jashtë shtetit nëse.”.

3. Germa “a” e pikës 3.1, të ndryshohet si më poshtë:

“a) STP-ja verifikon plotësimin e dosjes me dokumentet e kërkuara në shtojcën nr. 5 të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010. Kandidatët që paraqesin mangësi në dokumentacionin e aplikimit, përjashtohen nga përzgjedhja në fazat e mëtejshme.”.

V. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, komisionet përzgjedhëse dhe Sekretariati Teknik i Programit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj



UDHËZIM
Nr. 9, datë 4.7.2012

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 19.1.2012 “PËR PROCEDURAT E
NJEHSIMIT TË DËFTESAVE/DIPLOMAVE TË SHKOLLAVE TË MESME TË
SHTETASVE SHQIPTARË DHE TË HUAJ QË KANË KRYER ARSIMIN E MESËM
JASHTË SHTETIT”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të nenit 13 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimeve në shkollat e larta publike” të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 19.1.2012 “Për procedurat e njehsimit të dëftesave/diplomave të shkollave të mesme të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit” pika 4 germat “a”, “b” dhe “c” të ndryshojnë si më poshtë:

“4. Periudha kohore e njehsimit të dëftesave/diplomave të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që kanë fituar diplomë të shkollës së mesme jashtë shtetit, të jetë:

a) 15 mars - 15 prill dhe 15 gusht - 25 gusht: për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kërkojnë të vazhdojnë studimet në programet e studimit me kohë të plotë dhe me kohë të shkurtuar në IAL-të publike, në programet e studimit në IAL-të private.

b) shtator - dhjetor: për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kërkojnë të vazhdojnë studimet në programet e studimit në IAL-të private.

c) në çdo kohë: për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që nuk kërkojnë të vazhdojnë studimet universitare në Shqipëri.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Edukimit Parauniversitar, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe Komisioni i Posaçëm.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 8, datë 29.6.2012

**PËR KRITERET BAZË PËR NJOHJEN E LICENCAVE TË HUAJA TË PERSONELIT TË
MIRËMBAJTJES SË AVIONIT, NË LICENCË TË MIRËMBAJTËSIT AERONAUTIK**

Në përputhje me nenin 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 7, pika “ç” dhe nenit 33, pika 2 të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Qëllimi

Përcaktimi i kriterëve bazë dhe procedurave për njohjen e licencave të huaja të personelit të mirëmbajtjes së avionit në licencë të mirëmbajtësit aeronautik

2. Fusha e zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për personelin teknik të huaj të mirëmbajtjes, i cili punon në një organizatë shqiptare mirëmbajtjeje të miratuar, dhe zotëron:

- a) Licencë mirëmbajtësi aeronautik (LMA)-EASA nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian;
- b) Licenca të tjera jo nga shtetet të Bashkimit Europian.

3. Vlerësimi i licencave

Vlerësimi i licencave kryhet nga Autoriteti i Aviacionit Civil sipas rasteve:

a) për personelin referuar nën pikës “a” të pikës 2, AAC-ja rivlerëson licencat EASA, duke i pajisur me certifikatë njohjeje për licencë mirëmbajtësi aeronautik;

b) Për personelin referuar nën pikës “b” të pikës 2, Autoriteti i Aviacionit Civil nuk do të rivlerësojë në asnjë rast licenca të tilla.

4. Vlefshmëria e licencave

4.1 Licencat e rivlerësuara sipas nën pikës “a” të pikës 3 do të kenë vlefshmërinë njëvjeçare.

4.2 Ky proces do të jetë i vlefshëm deri në momentin që Republika e Shqipërisë do të bëhet anëtare me të drejta të plota në EASA.

5. Modeli i certifikatës

Në shtojcën bashkëlidhur, e cila është pjesë e këtij udhëzimi, paraqitet modeli standard i certifikatës së njohjes për licencë të mirëmbajtësit aeronautik - LMA.

6. Procedurat e konvertimit

Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për hartimin dhe nxjerrjen e procedurave përkatëse teknike për zbatimin e këtij udhëzimi.

7. Shfuqizime

Udhëzimi nr. 7, datë 29.3.2011 “Për procedurën e konvertimit të licencës kombëtare të personelit të mirëmbajtjes së avionit, në licencë të kufizuar të mirëmbajtësit aeronautik”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Adresa: "Sulejman Delvina" Nr. 1, Tiranë. Tel / Fax: +355 4 2223969, Email: _____@acaa.gov.al

Tiranë, më ___ / ___ / ___

ÇERTIFIKATË NJOHJEJE

Autoriteti i Aviacionit Civil autorizon teknikun z. _____ me licensë Nr. _____, të lëshuar nga _____, datë _____, me pasaportë me numër personal _____, të ushtrojë privilegjet e kësaj çertifikatë si më poshtë:

KOMPANIA	TIPI I AVIONIT	VLEFSHMËRIA E LIÇENSËS	
		NGA	DERI

DREJTOR EKZEKUTIV

URDHËR
Nr. 230, datë 5.7.2012

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave Zëvendësministrit të Brendshëm, z. Ferdinand Poni, të trajtimit të korrespondencës për marrjen e mendimeve nga ministritë e linjës lidhur me projektvendimet e pronave që hartohen nga Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, në zbatim të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, deri në revokimin e këtij urdhri.

2. Draftet përfundimtare të këtyre projektakteve paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave nga titullari i institucionit, në bazë të kreut VI, neni 43 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet Zëvendësministri i Brendshëm për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Flamur Noka

VENDIM
Nr. 82, datë 29.6.2012

PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË ENERGIJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2012, pasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike për një ndryshim në rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Në germën “e” të pikës IX.1.3 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, të bëhet ndryshimi si më poshtë:

“e) kjo dispozitë të jetë në fuqi deri në datën 31 korrik 2012.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim bohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 83, datë 29.6.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “REJ ENERGY”
SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET
“CEMERICA 1”, “CEMERICA 2”, “CEMERICA 3”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar nenit 4 pika 1 germa “a”, neneve 8, 9, 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Rej Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et “Cemerica 1”, “Cemerica 2” dhe “Cemerica 3”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 84, datë 29.6.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “REJ ENERGY”
SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8, 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10, pikat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit për licencë të shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 85, datë 29.6.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “SEAMENT
ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8 dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të



licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Seament Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Seament Albania” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Seament Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 86, datë 29.6.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “SEAMENT ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe nenit 45 pika “4”, dhe 48 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 5 pika 1 germa “f”, 8, 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Seament Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Seament Albania” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, germat “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Seament Albania” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 87, datë 29.6.2012

PËR RISHIKIMIN E TARIFËS SË FURNIZUESIT PUBLIK ME SHUMICË PËR PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014, PËR AKOMODIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE TË VENDIMIT NR. 80, DATË 15.6.2012 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S

Në mbështetje të neneve 7, 8 pika 2 germa “b”, “ç” dhe “dh”, neni 26 pika 1 dhe 27 pika 1 germa “dh” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 16 pika 2 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, pikat 1.3 dhe 5.7 të modelit shqiptar të tregut të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 239, datë 19.3.2008 dhe neneve 112, 121 dhe 128 të Kodit të Procedurave Administrative, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.6.2012, pasi u njoh me relacionin e grupit të punës të ngritur për akomodimin e efekteve të Borxhit të Keq dhe qëndrimet e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën e furnizimit publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, në vlerën 2.2 lekë/kWh.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 88, datë 29.6.2012

PËR MIRATIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2012

Në mbështetje të neneve 9 dhe 12 pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2012 pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Administrim Financës dhe Marrëdhënieve me Jashtë, mbi përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2012, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe konsideroi të drejtë llogaritjen e pagesave të rregullimit, sipas peshës specifike që zënë të ardhurat e secilit operator ndaj totalit të të ardhurave të sistemit,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2012 për të licencuarit në sektorin energjisë elektrike sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

42	HP OSTROVICA	10,000	85,500
43	Hidropower Elektrik		10,000
44	DN & NAT Energy		10,000
45	Selishte		10,000
46	Idro Energia Pulita		10,000
47	Bekim Energjitik		10,000
48	Euron Energy Group		10,000
49	"Erald Energjitik" sh.p.k		10,000
50	ERMA-MP sh.p.k		4,400
51	Dosku Energy		11,400
52	Diteko		10,000
53	Hec Lanabregas		10,000
54	Bistrica 1 & 2		10,000
55	Ulez - Shkopet		10,000
56	Hydro Salillari		10,000
57	Peshku Picar		10,000
58	Albania Power		10,000
59	HP Plant of Korça		10,000
60	Henz Energy		10,000
61	Hydro Borshi		10,000
62	Lu & Co Eco Energy		10,000
63	ENERGO SAS sh.p.k.		31,500
64	"Snow energy" sh.p.k.		10,000
65	"Stravaj Energji" sh.p.k.		10,000
II	License per ndertim, instalim dhe prodhim		
1	MUSO HEC QYTEZE sh.p.k.	5,000	5,000
2	REM sh.p.k.	10,000	10,000
3	ERS-08 shpk	10,000	10,000
4	E-VENTO sd ALBANIA sh.p.k.	20,000	20,000
5	ALBANIAN GREEN ENERGY sh.p.k.	20,000	20,000
6	HERA sh.p.k.	20,000	20,000
7	UNION EOLICA ALBANIA sh.p.k.	20,000	20,000
8	ALB WIND ENERGY sh.p.k.	20,000	20,000
9	BIOPWER GREEN ENERGY sh.p.k.	20,000	20,000
10	ENPOWER ALBANIA sh.p.k.	20,000	20,000
III	TRANSMETIMI		
1	OST sh.a	5,734,000	9,540,000
IV	License per shperndarje / furnizim		
1	OSSHCEZ Shpemdarda sh.a.	45,610,000	64,195,400
2	GSA sh.p.k.	144,000	200,000
3	ACR ENERGY sh.p.k.	10,000	10,000
4	KESH sh.a.	-	-
5	Gen - I TIRANA sh.p.k.	347,000	420,000
6	EFT-ALBANIA sh.p.k.	63,500	200,000
7	Cez TRADE ALBANIA sh.p.k	-	-
8	"Energy SUPPLY-AL" shpk		10,000
9	"Rudnap Energy Tirana" sh.p.k		10,000
10	ALBANIAN GREEN ENERGY sh.p.k		10,000
11	BALKAN GREEN ENERGY sh.p.k		10,000
12	"Hydro Salillari "sh.p.k		10,000
13	"Kurum" sh.a.		10,000
14	"Albpetrol" sh.p.k		10,000
V	License per tregtim		
1	GSA sh.p.k.	10,000	10,000
2	SPAHIU-GJANC sh.p.k.	10,000	10,000
3	UNIVERSI sh.p.k.	10,000	10,000
4	Gen-I TIRANA sh.p.k.	-	-
5	ENPOWER ALBANIA sh.p.k.	10,000	10,000
6	KESH sh.a.	-	-
7	WONDER-POWER sh.a.	10,000	10,000
8	EFT-ALBANIA sh.p.k.	-	-
9	EGL ALBANIA sh.a.	10,000	10,000
10	Cez TRADE ALBANIA sh.p.k.	157,500	190,000
11	Alpiq Energy Albania sh.p.k.	10,000	10,000
12	Cable System sh.p.k.	10,000	10,000
13	400 kV sh.p.k	10,000	10,000
14	"HYDRO ENERGY" SHPK	10,000	10,000
15	"Energy Partner AI" shpk	10,000	10,000



VENDIM
Nr. 89, datë 29.6.2012

**PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE NË MASËN 100%
NGA KOMPANIA “HEC LANABREGAS” TE SUBJEKTI “UJËSJELLËS-KANALIZIME”
SHA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, ligjit nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., “Hec Lanabregas” sh.a. dhe “Hec Bistrice 1 dhe 2” sh.a., vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 717, datë 20.10.2011 “Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a., të zotëruara nga METE, shoqërisë “Ujësjetllës-Kanalizime” sh.a. Tiranë., nenit 6.2 të licencës së prodhimit të energjisë elektrike dhe të nenit 5.3 të licencës së tregtimit të energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2012, pasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve në masën 100% nga shoqëria “Hec Lanabregas” sh.a. te subjekti “Ujësjetllës-Kanalizime” sh.a. Tiranë., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- Transaksioni i shitjes së aksioneve nga shoqëria “Hec Lanabregas” sh.a., te subjekti “Ujësjetllës-Kanalizime” sh.a. Tiranë, është realizuar në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 717 datë 20.10.2011 “Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a., të zotëruara nga METE shoqërisë “Ujësjetllës-Kanalizime” sh.a. Tiranë.

- Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave të sipërpërmendur është nënshkruar në datën 8.5.2012 dhe kontrata e shitjes me nr. 1588 Rep. dhe nr. 320/1 Kol. nga METE dhe subjekti “Ujësjetllës-Kanalizime” sh.a. Tiranë.

- Kontrata e nënshkruar nga palët ka në objekt transferimin e të drejtës së pronësisë dhe çdo të drejtë që lidhet me to nga shitësi “Hec Lanabregas” te blerësi “Ujësjetllës-Kanalizime” sh.a. Tiranë.

Për të gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e pronësisë së aksioneve në masën 100% nga kompania “Hec Lanabregas” te subjekti “Ujësjetllës-Kanalizime” sh.a. Tiranë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 90, datë 29.6.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“HEC VLUSHE” SHPK, PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SAJ SI KOLATERAL
PRANË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 8 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës me seri PV10P “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2012, pasi shqyrtoi kërkesën për lënie peng të aseteve si kolateral nga shoqëria “Hec Vlushe” sh.p.k. pranë Bankës Kombëtare Tregtare, si dhe relacionin Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec Vlushe” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2 emri dhe adresa e plotë e të licencuarit (janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte).

- Neni 7, pika 1.3, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij (ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja).

- Neni 7, pika 2,3,4 dhe 5 (ky informacion është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hec Vlushe” sh.p.k., për lënie peng si kolateral të 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 91, datë 29.6.2012

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GJO SPA POWER” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “LAPAJ”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe nenit 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar neneve 4 pika 1 germa “a”, 5 pika 1 germa “a”, 8, 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë



elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “GJO SPA Power” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe mbrojtjes së konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “GJO SPA Power” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “GJO SPA Power” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Lapaj” me fuqi 13.62 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 87, datë 22.6.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR TEPELENA SAT”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publike privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 01, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor Tepelena Sat”, në fushën e transmetimeve televizive kabllore private.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet nga data 10.4.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr. 88, datë 22.6.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR “RADIO LUSHNJA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publike privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 01, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Lushnja” në fushën e transmetimeve radiofonike vendore private.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet nga data 14.5.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

KËRKESË

Shtetësja Valentina Llanaj (Sadedinaj), e bija e Bajramit dhe Evjenisë, lindur më 27.12.1966, banuese në Sarandë, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetasit Shkëlqim Sadedinaj, i biri i Bajramit dhe Evjenisë lindur më 16.3.1971 në Sarandë.

KËRKUESE
Valentina Llanaj (Sadedinaj)

KËRKESË

Shtetasi Bruno Musha, i biri i Agimit dhe Irenës, i datëlindjes 9.12.1984, lindur dhe banues në Tiranë, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetasës Irena Seli.

KËRKUES
Burno Musha

KËRKESË

Shtetasi Ervin Patori, i biri i Xhemalit dhe Verores, i datëlindjes 2.3.1979, lindur dhe banues në Tiranë, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasës Verore Hoxha.

KËRKUES
Ervin Patori

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 6.8.2012
Doli nga shtypi më 6.8.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë